



Republika e Kosovës / Republic of Kosova  
Komuna - Municipality  
Hani i Elezit



01/Nr. 6148 /2023  
Data: 24.07. 2023

### PROCESVERBAL I KOMITETIT PER KOMUNITET

Nga mbledhja e gjashtë -VI- për vitin 2023 i Komitetit për Komunitete, mbajtur me datë: 27.06.2023 me fillim pune në ora 14:00 në sallën e takimeve. Prezent ishte z.Abduraman Bushi (Drejtor për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural).

### RENDI I PUNËS

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.
2. Takim me Nënkyetarin e Komunës.
3. Takim me përfaqësuesin e HENDIKOS në Han të Elezit.
4. Eventuale.

**Zaim Bela** thekson:- a keni ndonjë diskutim për rendin e punës, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

### U MIRATUA RENDI I PUNËS

#### 1.Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.

**Zaim Bela** thekson:- lidhur me këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

### U MIRATUA PROCESVERBALI NGA MBLEDHJA E KALUAR

#### 2. Takim me Nënkyetarin e Komunës.

**Zaim Bela** thekson:- si do të mbetet çështje e zyrtarëve të pylltarisë.

**Abduraman Bushi** thekson:- agjensioni përkatës i ka kërkuar listat e punëtorëve dhe është biseduar që deri në fund të vitit do të jenë me komunë.

**Zaim Bela** thekson:- a keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka kalojmë në pikën e radhës të parapri sipas agjendës.

### 3. Takim me përfaqësuesin e HENDIKOS në Han të Elezit.

**Zaim Bela** thekson:- për këtë pikë të rendit të hapi diskutimin, nëse nuk ka kalojmë në pikën e radhës të parapri sipas agjendës

### 4. Takim me Përfaqësuesin e Bizneseve në Han të Elezit.

**Zaim Bela** thekson:- a keni ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës , nëse nuk ka kalojmë në pikën e pestë të rendit të punës.

### 5.Eventuale

**Zaim Bela** thekson:- kemi dëgjuar që ju ka dhënë leje kompanisë ‘Sharrcem’ për djegëje të gomave. Për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

**Resul Suma** thekson:- duhet të shikohet se a i plotësojnë kriteret për me bërë djegëje sepse gomat nuk janë më të dëmshme se sa elementet tjera. Çështja e qenve endacak është bërë problem sepse janë shtuar.

**Hanumshahe Dibrani** thekson:- flitet se qenët endacak po i sjellin me kamionë

**Zaim Bela** thekson:- sipas informacioneve që kemi dëgjuar në muajin maj të vitit 2022 ju ka dhënë pëlqimi. A keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka shpalli të mbyllur mbledhjen.

Mbledhja përfundoj në 14:25.

Procesmbajtësi

Ayni Bushi



Anëtar i Vjetër i Komitetit

Zaim Bela

